



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË

Nr. 6354 Prot.

Korçë, më datë 01.11.2016

**NJOFTIM PËR PARAQITJE DOKUMENTACIONI**

Në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, të ligjit nr. 62, datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të VKM-së nr. 253, datë 06.03.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, si dhe të VKM-së nr. 813, datë 16.11.2016 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 253, datë 06.03.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, Bashkia Korçë njofton të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, të cilët nuk janë pajisur me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi, të paraqesin në bashki dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kërkesën për t’u pajisur me AMTP, për tokën që përdorin faktikisht, në të cilën përcaktohen numri kadastral i ngastrës ose emërtimi popullor, sipërfaqja e saj dhe kufitarët;
- b) Planvendosja e secilës ngastër që kanë në përdorim, të përgatitur nga një subjekt i licencuar, sipas kërkesave të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku të pasqyrohen sipërfaqja, kufijtë e saj dhe kufitarët;
- c) Çertifikatën e gjendjes familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, ku të pasqyrohet numri i frymëve të familjes përfituese ose individit, në favor të të cilit do të lëshohet akti i ri i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më 1 gusht 1991;
- ç) Dokumentacionin që vërteton se është përfitues si rezultat i lëvizjes nga qendrat e tyre të banimit, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave.

Të gjithë përdoruesit faktikë të tokës bujqësore të ish-kooperativave bujqësore, që dëshirojnë të pajisen me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi kanë të drejtë të paraqesin gjithë dokumentacionin e sipërcituar pranë Bashkisë Korçë deri në datë **30.09.2017**.

U afishua në datë \_\_\_\_\_

Administratori \_\_\_\_\_

emër, mbiemër, firmë

